



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 320/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Hasan Shala, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Fryma e Re ( FER ), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të mbulimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2010, mori këtë:

## V E N D I M

**MIRATOHET** ankesa si e bazuar.

Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 3200 (tremijedyqind) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Subjekti politik Fryma e Re, ka parashtruar ankesë më te cilën pretendon se subjekti politik PDK, ka bërë shkelje të nenit 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*, sepse subjekti politik PDK, i ka mbuluar posterat e subjektit politik Fryma e Re (FER) , duke i vendosur posterat e kandidatëve të saj për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës.

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 04.12.2010, nga subjekti politik Fryma e Re, në të cilën theksohet subjekti politik PDK, në komunën e Malishevës i ka mbuluar posterat e subjektit politik Fryma e Re, duke i vendosur posterat e kandidatëve të PDK-së për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës, mbi posterat e subjektit politik Fryma e Re, e që është në kundërshtim me nenin 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi, në të cilën shihet qartë se si posterat e kandidatëve nga radhët e subjektit politik PDK, janë vendosur mbi posterat e subjektit politik Fryma e Re.

Parashtrusi i ankesës propozon qe të ndërmerren masat e parapara ligjore.

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it.

PZAP-i e informoi subjektin politik PDK, më datë 05.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 06.12.2010, gjerë në ora 12:00.

PZAP-i, nuk mori përgjigjeje në ankesë nga subjekti politik PDK, sipas afatit të caktuar.

### **Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike**

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (a) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërsi në vijim:*

*a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;*

### **Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve**

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

*Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:*

*c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).*

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se posterat e kandidatëve për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës, nga radhët e subjektit politik PDK, janë vendosur mbi posterin e subjektit politik Fryma e Re, nga kjo arsye e më qëllim të evitimit të shkeljes së lartë cekur dhe në pajtim më dispozitat e lart cekura ligjore, PZAP-i vlerëson se ankesa është e bazuar, e lidhur me nenin 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 320/2010 më datën 06.12.2010

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**

